



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 3, datë 20/01/2020

MBI

“MIRATIMIN E NUMRIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ETIKËS SI DHE PËRBËRJEN E TIJ”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 44 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në urdhrin e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, pasi e diskutoi mbi numrin dhe përbërjen e anëtarëve të Këshillit të Etikës për Universitetin e Arteve, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e përbërjes së Këshillit të Etikës për UART me një numër prej 5 (pesë) anëtarësh.
2. Secili Fakultet gëzon të drejtën e përfaqësimit me një anëtar nga stafi akademik. Anëtari duhet të ketë një eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vite në UART dhe të jetë i kategorisë Profesor. Kandidimi i personelit akademik bëhet me vetëkandidim ose me propozim nga Dekanati.
3. Njëri nga anëtarët e Këshillit të Etikës është anëtar i Senatit Akademik të UART. Anëtari përfaqësues i Senatit Akademik duhet të ketë një eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vite në UART dhe të jetë i kategorisë Profesor. Kandidimi i anëtarit të Senatit Akademik bëhet me vetëkandidim.
4. Njëri nga anëtarët e Këshillit të Etikës është nga kategoria Student e UART. Kandidimi i anëtarit nga kategoria Student, bëhet me propozim nga Këshilli Studentor ose me vetëkandidim.
5. Kandidatët për anëtarë të Këshillit të Etikës nga të gjitha kategoritë e sipërcituara, duhet të dorëzojnë kërkesën për vetëkandidim deri më datë 27.01.2020, ora 10:00, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të UART, sipas modelit të kërkesës shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Lista e kandidatëve të ndarë sipas kategorive të sipërcituara votohen nga Senati Akademik i UART.
7. Anëtari i Këshillit të Etikës i zgjedhur si pjesë e Senatit Akademik nëse kandidon për organe drejtuese ose autoritet drejtuese në UART, nuk merr pjesë në diskutimet që kanë të bëjnë me personin e tij/saj.
8. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Asoc. Genc MULLIQI

Urim ALIAJ

Rajmond PRENDUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËRKESË
PËR REGJISTRIM
SI KANDIDAT PËR ANËTAR
TË KËSHILLIT TË ETIKËS
UNIVERSITETI I ARTEVE**

Nr. _____

Datë ___ / ___ /2020

KËRKESË

Bazuar në 44 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Urdhrin e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë” si dhe Vendimin e Senatit Akademik Nr. 3, datë 21.01.2020,

Unë _____ paraqes **KËRKESËN** për regjistrim si kandidat për anëtar të **KËSHILLIT TË ETIKËS** në Universitetin e Arteve.

TË DHËNA TË KANDIDATIT (Plotëso me germa të mëdha, vendos shenjën X në kuti)

Emri				Vjetërsia në punë		
Mbiemri				Nr. i Letër njoftimit		
Atësia				Gjinia	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>
Datëlindja	_____ dita	_____ muaji	_____ viti	Titulli		
Fakulteti	FM <input type="checkbox"/>	FAS <input type="checkbox"/>	FAB <input type="checkbox"/>	Pozicioni aktual		

Shënim: Gjithashtu deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime në këtë kërkesë janë të sakta dhe të vërteta. Jam në dijeni se deklarimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë, përveç përgjegjësisë penale, sjell automatikisht heqjen e të drejtës për kandidim për këtë pozicion.

Emër Mbiemër

Firmë